



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

---

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

**P R O C E S V E R B A L**

Nga mbledhja e dytë të Legjislacionit të VIII<sup>-të</sup> të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 16.01.2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                                 |
|---------------------------------|---------------------------------|
| 1. Naim Behlulaj, LDK;          | 15. Ali Nimanaj, PDK;           |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 16. Astrit Hajrizaj, PDK;       |
| 3. Agon Dreshaj, LDK;           | 17. Kaltrina Arifaj, PDK;       |
| 4. Zenel Shatri, LDK;           | 18. Arben Kabashi, PDK;         |
| 5. Arianit Selmanaj, LDK;       | 19. Nexhmedin Balaj, PDK;       |
| 6. Kushtrim Buleshaj, LDK;      | 20. Lirie Demiraj Sadikaj, PDK; |
| 7. Merita Muzlijaj, LDK;        | 21. Astrit Bujupaj, VV;         |
| 8. Enver Rugova, LDK;           | 22. Niman Beqiraj, VV;          |
| 9. Faruk Kabashi, LDK;          | 23. Floriana Maxharraj, VV;     |
| 10. Ruzhdi Metaj, LDK;          | 24. Ukë Blakaj, AAK;            |
| 11. Arta Balaj, LDK;            | 25. Fjolla Ukaj, AAK;           |
| 12. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 26. Lulzim Shoshi, L.SH;        |
| 13. Ajshe Imeraj, LDK;          | 27. Valmir Rama, IRDK;          |
| 14. Abetare Sutaj Arifaj, LDK;  |                                 |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, përfaqësues të OSBE-së (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar  
Link ).

Mbledhjen e hapu dhe e kryesoi, anëtari me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.

**Anëtari me i vjetër i Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje, dhe i njofton me rendin e ditës për këtë mbledhje. Konstaton së të gjithë anëtarët e kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojnë me mbledhjen, vazhdon:

Procesverbali

## **R e n d   d i t e**

### 1. Zgjedhja e Kryesuesit te Kuvendit te Komunës.

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri – sqaron procedurat e zgjedhjes se kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Para propozimeve për kryesues, anëtarët e kuvendit duhet të japin propozimet e tyre për të formuar komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, i cili komision mund të ketë përbërjen prej 3 ose 5 anëtarësh.

Kush është që komisioni te zgjidhet prej 3 anëtarësh

Votohet unanim nga anëtarët e Kuvendit.

Vazhdojmë me propozimet për këtë komision:

Merita Bytyqi, LDK – nga radhët e LDK-së propozon Agon Dreshaj,

Astrit Hajrizaj, PDK – nga radha e PDK-së propozojmë Arben Kabashi.

Niman Beqiraj, VV – nga radhët e VV propozon Florin Dreshaj,

Kryesues i mbledhjes – hedhe në votim komisionin votohet unanim nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Agon Dreshaj, LDK
2. Arben Kabashi, PDK dhe
3. Florin Dreshaj, VV.

Lut qytetaret që për shkak të hapësirës dhe votimi të lirshëm ta lirojnë sallën.

Ju lutem të mirëkuptohemi.

Fillojmë me Propozimet për kryesues të Kuvendit të Komunës:

Naim Behlulaj, LDK, Propozon Enver Rugoven nga radhët e LDK-së.

Pasi propozime tjera nuk ka vazhdojmë.

Thërret sekretarin e Kuvendit që të bëjë përgatitjen e votimit.

Pasi që sekretaria e Kuvendit beri të gjitha përgatitjet e duhura.

Vazhdojmë me votim,

Nga sekretaria kanë ardhur 30 fletë votime, lista me emrat e anëtarëve të kuvendit e cila duhet të nënshkruhet nga të gjithë votuesit, të cilat u verifikuan nga komisioni, dhe janë në rregull.

Komisioni i përzgjedhur për mbarëvajtjen e votimit fillon me punë, thërret anëtarët e Kuvendit me listë dhe merr nënshkrimet e tyre ashtu siç janë në bazë të renditjes.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit votojnë në mënyrë të fshehtë.  
Mbarëvajtja e votimit shkon në rregull pa probleme.

Pas votimit komisioni:

Konstaton se votimi ka përfunduar në mënyrë të rregullt, nga 30 fletëvotime sa ka pasur kanë mbetur 3 të cilat i dorëzohen sekretarisë së kuvendit.

Fillojnë me numërimin e votave:

Komisioni konstaton se nga 27 vota gjithsejtë:

Kandidati i vetëm i propozuar për Kryesues të Kuvendit z. Enver Rugova

Merr këtë rezultat:

Pro 18 vota,

Kundër 6 vota dhe

3 fletëvotime të pa votuara.

Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut edhe për një mandat zgjedhtë z. Enver Rugova me 18 vota për.

Kryesues i mbledhjes – pasi që komisioni përfundoj punën, kryesues i kuvendit për legjislacionit të VIII-të, u zgjodh i uron për marrë e detyrës dhe i dëshiron punë të mbar.

Fton kryesuesin që ta marr detyrën dhe të ulet në vendin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Dhe e fton për një fjalë rasti.

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati, i uron Kryesuesit të Kuvendit për marrjen e mandatit dhe i uron punë të mbar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova – përshëndet të gjithë të pranishmit, falënderon anëtarët e kuvendit për besimin e dhënë, dhe shprehë gadshmerin e bashkëpunimit.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.  
Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:00.

**Procesmbajtëse,**  
**Vjosa Hysenaj**

3

Procesverbali

**Kryesues i mbledhjes,**  
**Zenel Shatri**

